



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 3473 (55000-000365-30-2020) çështje

Shkurtim Vendimi

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e përbërë prej:

**Relatore:** Elona TORO  
**Anëtare:** Genti SHALA  
**Anëtare:** Iliba BEZATI

I mbajtur sot me datë 26.09.2024, asistuar nga sekretare gjyqësore **Remila Mema**, mori në shqyrtim çështjen penale me palë:

**KUNDËR:**

**Të pandehurit Albert Veliu**, i biri i Eqerem dhe Abe, i dtl. 19.01.1967, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë: Lagjia “4 Heronjtë”, Rruga: “Isa Boletini”, Pall.1004, Shk. I, Kat. II-të, Vlorë, me arsim 10 klasë, i martuar, me dy fëmijë, hetuar me masën e sigurimit personal “arrest në burg” në mungesë, i deklaruar në mungesë në gjykim (i ikur) i mbrojtur nga mbrojtësja e caktuar kryesisht Elona Ullorja.

**AKUZUAR:**

Për kryerjen e veprave penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” dhe “Kallëzimi i rremë” i kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 297, 305 e 25 të K.Penal.

**Të pandehurit Fredi Alizoti**, i biri i Elmaz dhe i Ildize, i dtl.13.04.1973, lindur dhe banues në Fier, Lagjia “1 Maji”, i divorcuar, me arsim 8-vjeçar, i pranishëm në gjykim, i hetuar me masën e sigurimit personal “arrest në burg”, i mbrojtur nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij **Av. Ilir Dode**.

**AKUZUAR:**

Për kryerjen e veprës penale “Kallëzimi i rremë” i kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

**Të pandehurit Jetmir Olldashi**, i biri i Tahir dhe i Fatime, i dtl. 30.05.1981, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga “Mikel Maruli”, i padënuar, i divorcuar, me arsim të lartë, hetuar me masë sigurimi “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, i deklaruar në mungesë në gjykim, përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur **Av. Indrit Sefa**.

**AKUZUAR:**

Për kryerjen e veprës penale “Kallëzimi i rremë” i kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

**Të pandehurit Ervin Salianji**, i biri i Bujar dhe Shegë, i dtl. 16.01.1988, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me adresë: Rruga “Asim Vokshi”, i padënuar, me arsim të lartë, hetuar në gjendje të lirë, i mbrojtur nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij **Av. Ledio Braho**.



**AKUZUAR:**

Për kryerjen e veprës penale “Kallëzimi i rremë” i kryer në bashkëpunim të parashikuar nga nenet 305 e 25 të K.Penal.

**VIKTIMA/KALLËZUES:** Geron (Agron) Xhafaj, i biri i Sezai dhe Elpiniqi, i dtl.08.06.1975, lindur e banues në Vlorë, Lagjia: “Isa Boletini”, Rruga “Mehmet Petoshati”, Nd. 45, H. 3, Apt. 32, në mungesë, i përfaqësuar nga Av. Ardian Visha dhe Av.Arben Prenga (sipas Prokurës Nr. 2554 Rep., Nr. 717 Kol., dt. 15.05.2018).

**Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin penal Nr. 2059 (30-2024-6822), datë 26.09.2024**

**VENDOSI:**

1. Mospranimin e ankimit të ushtruar nga i pandehuri Fredi Alizoti, ndaj vendimit Nr. 2900, datë 18.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
  2. Lënien në fuqi të vendimit Nr. 2900, datë 18.12.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 45 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.  
U shpall në Tiranë, sot më datë 26.09.2024.

**Anëtare**  
**Iliba BEZATI**  
d.v

**Anëtar**  
**Genti SHALA**  
d.v

**Relatore**  
**Elona TORO**  
d.v

**Vërtetohet njësia me origjinalin**

**Kryesekretare/Rudina BUBJAKU**

**Konceptoi**

**Sekretare Gjyqësore/Remila Mema**



*Bubjaku*